

Data_____

PROCES - VERBAL ARGUMENTIMI
Tipi i kontratës - Sherbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

Sherbimi i GPS për mjetet motorike të OSHEE GROUP sh. a.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 38112100-4, Sisteme GPS ose të ngjashme.

VLERA E FONDIT LIMIT:

- 2,412,000 (Dy milion e katërqind e dymbëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor sh.a, ka hartuar proces - verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Procedura e prokurimit është nën kufirin e ulët monetar. Në përputhje me nenin 33 të LPP dhe VKM 291 DT. 15.05.2024, kufijte monetare janë:

KREU II KUFIJTË MONETARË NË SEKTORIN KLASIK

1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

- a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 528 781 400 (pesëqind e njëzet e tetë milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind) lekë
- b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 13 699 000 (trembëdhjetë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë)4 lekë.

2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

- a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë;
- b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

Per sa mesiper, referuar Nenit 49 te LPP ku shprehet qe Autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën e hapur të thjeshtuar për kontrata nën kufirin e ulët monetar, AK ka vendosur qe Procedura te jete e hapur e thjeshtuar – Sherbime.

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “OSHEE GROUP” sh.a. ka vendosur qe kjo procedure te mos jete ne lote sipas arsyetimit te meposhtem:

OSHEE Group sh.a, menaxhon monitorimin e automjeteve me sistemin GPS nga Zyrat Qendrore, duke pasur dhe nje staf te dedikuar, ne Drejtorite Rajonale nuk ka strukture per monitorimin e ketij procesi. Per sa mesiper, duke qene se ky sherbim shtrihet ne te gjithe qarqet ku OSHEE Group sh.a ushtron aktivitetin dhe menaxhohet/monitorohet nga qendra, nuk mund te ndahet ne lote.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar.

Kërkesat e mësipërme janë detyruese dhe i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për të krijuar bindjen e tij se operatorët ekonomik pjesëmarrës ushtrojnë veprimtarinë e tyre konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, përmbushin kriteret ligjore për të marrë pjesë në procedura prokurimi si dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet tatimore dhe ato të energjisë elektrike sipas përcaktimeve të legjislacionit përkatës.

Po ashtu, paraqitja e sigurimit të ofertës është detyrim ligjor i përcaktuar nga legjislacioni në fuqi mësipërcituar, si një mjet garancie për AK në rast të tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave, refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit apo mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimit

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 900,000 (Nentëqind mije) leke pa TVSH.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure dhe nenin 77 pika 3, e LPP, ne nenin 43 pikat 1, 2, dhe 3 të dhe nenin 55 pika 4 e VKM

nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku percaktohet se: Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar”

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë rendesinë, fondin limit të kësaj kontrate, OE ofertues duhet të vërtetojë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë arsye, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik ndaj është argumentuar se vlera mesatare e xhiros për tre apo më pak vitet e fundit financiare të jete në masën 900,000 (Nentëqind mijë) leke pa TVSH, duke qendruar madje brenda normes prej 40 % të vlerës së fondit limit që prokurohet, norme që percaktohet si limit i mundshëm nga LPP 162/2020 dhe në nenin 55 pika 4 e VKM 285/2021 e ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar nën 13 pika 2: *“Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore,”*.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar të xhiros është Brenda marzhit të lejuar që mund të kërkohej. Gjithashtu për të stimuluar të gjithë operatorët e rinj që operojnë në treg si dhe për rritur numrin e konkurrentëve në këtë procedurë është gjykuar që vlera e xhiros së kërkuar të jete jo më tepër se 40 % e vlerës së parashikuar të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke u bazuar në Nenin 43, pika 1 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku percaktohet se:” Autoriteti / enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Ndër të tjera, përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke u mbështetur gjithashtu dhe në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarinimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përkatësisht në miratimin e këtij kriteri është mbajtur në vëmendje neni 29 i Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” ku përcaktohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. “

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqese deshmi per:

Sherbime të ngjashme për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 400,000 (Katerqind mijë) leke.

- Për sherbime të mëparshme të realizuara me sektorin publik, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe **shërbimet e realizuara**.
- Në rastin e sherbimeve të mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sherbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që sherbimet e ngjashme të jenë në vlerën jo më shumë se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë faktin që të krijohen kushtet për një konkurrencë të hapur dhe për të mos minimizuar artificialisht numrin e operatoreve ekonomik që ofrojnë këto lloje sherbimesh, pavarësisht rendesise dhe kompleksitetit të objektit të procedurës të prokurimit, bazuar dhe në frymën e konkurueshmërisë që gjeneron LPP 162/2020 është gjykuar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë realizuar me kontrata të ngjashme, të jetë nën 20 % e vlerës së parashikuar (në vijimesi edhe me LLP) dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues do

jete realisht ne gjendje te realizoje kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa te ndryshme qe do te ndikonin ne ecurinë e punës se AK, autoritetet kontraktore mban në konsideratë kriteret të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar si kompani sipas standardeve ndërkombëtare:

ISO 9001 ose ekuivalente të sistemit të menaxhimit të cilësisë (të vlefshme),

ISO 27001 ose ekuivalente për Sigurinë e Informacionit (të vlefshme),

ISO 45001 ose ekuivalente për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, (të vlefshme)

ISO 20000-1 ose ekuivalente, për menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit. (të vlefshme)

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/çertifikimet e duhura organizative dhe operationale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Certifikimi **ISO 9001** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësive implementuese.

Certifikimi **ISO 27001** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke siguruar që informacionet (siç janë ato që përmbajnë sistemet ekzistuese të AK dhe e kanë një rëndësi dhe konfidencialitet të lartë) të menaxhohen në mënyrë të sigurtë nga pikepamja informatike dhe të jenë të kontrolluara si dhe aksesimi mbi to të jetë i verifikueshëm e i kodifikuar). Kjo vjen pasi në këto kontrate do të ketë edhe furnizime të reja në sistemet ekzistuese që kërkojnë kompetencë të shtuar profesionale në këto drejtim.

Certifikimi **ISO 20000-1** ose ekuivalente shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke qenë se zoteron një sistem menaxhimi për shërbimet e teknologjisë së informacionit, duke pasur me shumë garanci që ky i fundit të planifikojë, krijojë, zbatojë, monitorojë, rishikojë, mirëmbajë dhe përmirësojë të gjithë sistemin në teresi i cili është teresisht i bazuar në produkte TIK (software dhe hardware);

Certifikimi **ISO 45001** ose ekuivalent ka të bëjë me sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, ky standart është i nevojshëm pasi vete karakteristikat e punës, duhet të vërtetohet se e menaxhon në mënyrë të sigurt

2.3.3 Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas termave objektivit të prokurimit dhe/ose komponentët e saj, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të vërtetojë se ka të punësuar të paktën 6 (Gjashtë) punonjës, të cilët të figurojnë në listpagesa të pakten në muajin e fundit nga data e hapjes së procedurës. Ky staf kryesor duhet të jetë i kualifikuar dhe trajnuar mirë në fushën e inxhinierisë dhe sigurisë informatike, të cilët duhet të disponojnë të paktën certifikimet si më poshtë vijon:

- 2 (dy) Inxhinierë të diplomuar në njërin nga fushat: Inxhinieri Elektronike, Inxhinieri Informatike ose Teknologji Informacioni.
- Të pakten 1 punonjës të licensuar dhe të pajisur me certifikatat e trajnimeve perkatese të kryera nga kompania prodhuese e pasijeve të ofertuara.
- 1 (një) punonjës të certifikuar në gradën EKSPERT në databaza SQL
- 1 (një) punonjës të certifikuar Project manager.
- 1 (një) punonjës të certifikuar zhvillues aplikacioni.

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës në formatin e përcaktuar nga ligji e vlefshme dhe dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik nga institucione të akredituara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente.

Një punonjës mund të disponojë më shumë se një certifikim.

Sqarim: përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin).*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, I ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personel te nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Duke u bazuar ne preventivin e ketij investimi, jane parashikuar te montohen 360 sisteme GPS me aksesore perkate, per nje afat kohor prej 3 ditesh, ne te gjitha Drejtorite Rjionale. Nisur dhe nga eksperiencat e meparshme, minimumi i punonjesve per te realizuar kete sherbim eshte 6.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë Autorizim te prodhuesit / Distributorit te autorizuar (MAF) per te gjitha produktet dhe sistemet e ofertuara. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit / Distributorit te autorizuar si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij. Distributor duhet te provoje lidhjen me prodhuesin.

Shenim: *Operatori ekonomik /Bashkimi i operatoreve, duhet të ofertojë vetëm me një prodhues për secilin artikull, rastet kur paraqiten autorizime nga dy ose më shumë prodhues për të njëjtin artikull, përbëjnë objekt skualifikimi.*

Duke mbajtur ne konsiderate piken 6/a te nenit 41 te VKM 285 për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, me mallra cilesore, autoriteti/enti kontraktor kërkon Autorizim te prodhuesit / Distributorit te autorizuar (MAF) per te gjitha produktet dhe sistemet e ofertuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje dhe propocion me natyrën, objektin dhe volumin e kontratës objekt prokurimi. Duke marrë në konsideratë edhe natyrën, zërat të cilat kanë volum maksimal të lëndës bazë dhe materialeve të kryerjes së punimeve. Kriteri i përcaktuar mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga distributor i Autorizuar nga Prodhuesi është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara nga prodhuesi. Në këtë kontekst, referuar vlerës së kontratës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dokumentit te cituar nuk ka kufizuar konkurrencën, pasi një kriter i tillë nuk është diskriminues për operatorët ekonomikë. Për autoritetin është e rëndësishme që të sigurohet sherbim me “mall” sipas standarteve të kërkuara, specifikimeve teknike, e gjithashtu dokumentacioni i kërkuar për tu paraqitur është i parashikuar dhe brenda kuadrit ligjor të sipërcituar. Neni 39 e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 i jep mundësinë autoriteteve kontraktorë t’u kërkojnë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet

e tenderit, si: dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: specifikimet teknike, të cilat shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha shërbimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku çdo referencë shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”, janë pjese ne DST e kesaj procedure.

Në specifikimet teknike, objekti i kontratës, nuk është përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve.

Termat e References dhe kriteret e vecanta per kualifikim jane hartuar nga grupi i punes i ngritur me urdher te posacem nga titullari, duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per shërbimet objekt procedure prokurimi, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”.